



PhD. Erion Kristo

Pedagog në
Departamentin e Qeverisjes,
Shkenca Politike dhe
Komunikim

KONTAKTE

✉ e.kristo@umb.edu.al



PhD. Erion Kristo

Pedagog në
Departamentin e Qeverisjes,
Shkenca Politike dhe
Komunikim

BIOGRAFIA

Dr. Erion Kristo është diplomuar në Universitetin “San Tommaso”, Fakulteti i Filozofisë, për Filozofi në vitin 1994. Në vitin 1996 ka marrë gradën “Master i Shkencave” në Filozofi, po nga ky universitet. Gjatë periudhës 2001-2002 ka ndjekur një Master për “Administrim Menaxhim” në Universitetin “Montesquieu BORDEAUX IV” në Francë, ndërsa në vitin 2017 ka marrë gradën “Doktor i Shkencave” në Filozofi .

Gjatë periudhës 2000-2007 ka punuar përkatësisht në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe në Institutin e Monumenteve të Kulturës. Që prej vitit 2008 është i angazhuar si pedagog në Universitetin “Barleti”, në Departamentin e Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, dhe si analist, gazetar dhe drejtues i emisionit “BARDHAZI” në TV. SCAN.

Dr. Erion Kristo ka një sërë publikimesh në shtypin e përditshëm, si tregime, poezi, ese dhe përkthime nga autorë të ndryshëm. Ka shkruar një mori artikujsh kritikë për letërsinë në revista dhe gazeta, redaktor i dhjetëra librave të botuar, bashkëpunëtor në serinë e botimeve të Oxfordit, botuar nga IDEART dhe është fitues i bursës Fullbright Scholar në UCLA Los Angeles, në Departamentin e Shkencave Politike gjatë periudhës Janar – Korrik 2012. Ka një pjesëmarrje të gjatë si aktivist në shoqërinë civile dhe media, si dhe një përvojë të gjatë në mësimdhënie në lëndët: “Sociologji”, “Antropologji Sociale”, “Probleme sociale”, etj.